



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2017

PËR

NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10316, DATË 16.9.2010 “PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7764, DATË 02.11.1993 “PËR INVESTIMET E HUAJA””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10316, datë 16.9.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr.7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë vijon :

Neni 1

Në nenin 3 “Dispozitë kalimtare”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë :

1. Fjalët "31 Dhjetor 2014" zëvendësohen me fjalët "31 Dhjetor 2018".
2. Pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Mbrojtje të posaçme shtetërore sipas parashikimeve të neneve 8/b, pikave 1, 2 dhe 4; 8/d dhe 8/dh të këtij ligji, përfitojnë automatikisht, pa patur nevojën e ndjekjes së procedurës së parashikuar në nenet 8/c dhe 8/ç, dhe investitorët/investimet strategjike, procedurë e asistuar/e veçantë që kanë marrë këtë status në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KUVENDIT

ILIR META